

## 8.6 REGJISTRIMET LOKALE

Regjistrimet lokale krijohen nga konvertimi i regjistrimeve nga sistemi, të cilin biblioteka e ka përdorur para se t'i bashkohet sistemit COBISS dhe janë të shënuara vetëm në bazën lokale të të dhënave.

Para redaktimit të regjistrimit lokal duhet të verifikoni në COBIB, nëse ekziston regjistrimi për të njëjtin burim bibliografik. Nëse ekziston, regjistrimin nga baza lokale e fshini dhe e kopjoni atë nga COBIB-i. Nëse regjistrimi në COBIB nuk është, regjistrimin lokal e plotësoni, e redaktoni dhe më pas e ruani edhe në COBIB.



Këshillë:

Të gjitha regjistrimet lokale në bazën bibliografike të të dhënave mund t'i kërkonte në këtë mënyrë: në dritaren për kërkim të klasës **Regjistrimi bibliografik** te "Kërkimi i specializuar" shënoni *CR=<krijuesi, i përcaktuar gjatë konvertimit>* (zakonisht *CR=\*OLD*), ndërsa te "Skanimi" *000e=only*.

### 8.6.1 Regjistrimi lokal është regjistrim dublikatë

Kjo procedurë përdoret, nëse për të njëjtin burim bibliografik ekziston regjistrimi edhe në COBIB.

#### Procedura

Dritarja **Regjistrimi bibliografik**.

1. Përzgjidhni metodën **Kërkimi** / **<akronimi i bazës lokale të të dhënave>/COBIB**.

Hapet dritarja **Kërkimi – Regjistrimi bibliografik (<akronimi i bazës lokale të të dhënave>)**.

2. Shënoni pyetjen e duhur për kërkim dhe ekzekutoni kërkimin në bazën lokale të të dhënave. Procedura e kërkimit është e përshkruar gjërësisht në kap. 4.

Regjistrimi për burimin bibliografik ndodhet në mesin e rezultateve të kërkimit.

3. Përzgjidhni regjistrimin e duhur në listën e rezultateve dhe klikoni butonin **Përzgjidh**.

Regjistrimi, të cilin e keni përzgjedhur, shtohet si skedë në kujtesën e fragmenteve të regjistrimeve.

4. Në të njëjtën mënyrë e kërkonte regjistrimin përkatës nga COBIB-i dhe e shtoni në kujtesën e fragmenteve të regjistrimeve.
5. Përzgjidhni skedën, në të cilën është regjistrimi nga COBIB-i dhe më pas metodën **Regjistrimi / Shkarko regjistrimin**. Ndiqni hapat nga 5 deri në 7 të kap. 8.2.1. dhe hapat më pas hapat e tjerë në vazhdim.

6. Nga regjistrimi, të cilin planifikoni ta fshini në bazën lokale, në modulën COBISS3/Koleksionet transferoni të dhënat për koleksionet (nëse ekzistojnë) në regjistrimin që dëshironi ta mbani.
7. Në kujtesën e fragmenteve të regjistrimeve përzgjidhni skedën me regjistrimin lokal dhe metodën **Regjistrimi / Shto regjistrimin lokal në COBIB**.

Regjistrimi ngarkohet në redaktues. Në të njëjtën kohë aplikohet edhe verifikimi automatik i regjistrimit. Nëse regjistrimi përmban gabime, hapet dritarja me listën e gabimeve. Dritaren e hapni duke klikuar butonin **Në rregull**.

8. Përzgjidhni metodën **Regjistrimi / Fshi regjistrimin**.

Regjistrimi fshihet nga baza lokale e të dhënave. Programi ju lajmëron se regjistrimi është fshirë.

---

## 8.6.2 Regjistrimi lokal nuk është regjistrim dublikatë

Kjo procedurë përdoret, nëse për të njëjtin burimi bibliografik, nuk ekziston regjistrimi në COBIB.

### *Procedura*

Dritarja **Regjistrimi bibliografik**.

1. Përzgjidhni metodën **Kërkimi / <akronimi i bazës lokale të të dhënave >/COBIB**.  
Hapet dritarja **Kërkimi – Regjistrimi bibliografik (<akronimi i bazës lokale të të dhënave>)**.
2. Shënoni pyetjen për kërkim dhe kërkoni në bazën lokale të të dhënave. Procedura e kërkimit është përshkruar gjërësisht në kap. 4.  
Regjistrimi për burimin bibliografik ndodhet në mesin e rezultateve të kërkimit.
3. Përzgjidhni regjistrimin në listën e rezultateve të kërkimit dhe klikoni butonin **Përzgjidh**.  
Regjistrimi, të cilin e keni përzgjedhur, shtohet si skedë në kujtesën e fragmenteve të regjistrimeve.
4. Përmes dritares për kërkim verifikoni, nëse në COBIB ekziston regjistrimi për burimin e njëjtë bibliografik.  
Regjistrimi për burimin bibliografik nuk ndodhet në mesin e rezultateve të kërkimit.
5. Mbyllni dritaren për kërkim dhe në kujtesën e fragmenteve të regjistrimeve përzgjidhni skedën me regjistrimin lokal, pastaj përzgjidhni metodën **Regjistrimi / Shto regjistrimin lokal në COBIB**.

Regjistrimi ngarkohet në redaktues. Në të njëjtën kohë aplikohet edhe verifikimi automatik i regjistrimit. Nëse regjistrimi përmban gabime, hapet

dritarja me listën e gabimeve. Dritaren e mbyllni duke klikuar butonin **Në rregull**.



Shënim:

*Regjistrimet lokale nuk mund të redaktohen me metodën **Regjistrimi / Redakto regjistrimin**.*

6. Përmirësoni apo plotësoi të dhënat në regjistrim. Procedura e punës në redaktues është përshkruar në kap. 7.

7. Regjistrimin e ruani me metodën **Regjistrimi / Ruaj regjistrimin**.

Nëse në regjistrim ka gabime, të cilat mund të gjenden në mënyrë automatike, programi ju paralajmëron, ashtu siç ju paralajmëron edhe për regjistrimet në COBIB, të cilat mund të jenë regjistrime dublikatë të regjistrimit që sapo keni redaktuar (shih kap. 7.1.10).

Regjistrimi ruhet në COBIB dhe në bazën lokale të të dhënave.



Shënim:

*Gabimet, për të cilat programi ju paralajmëron, duhet të verifikohen dhe sipas mundësisë të përmirësohen.*